FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2021 – Numri: 175

Tiranë – E enjte, 11 nëntor 2021

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 664, datë 10.11.2021	Për emërim në detyrë.....	15585
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 665, datë 10.11.2021	Për një shtesë në vendimin nr. 586, datë 30.8.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për punësimin e përkohshëm të studentëve të ekselencës në institucionet e administratës shtetërore", të ndryshuar.....	15585
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 666, datë 10.11.2021	Për disa shtesa në vendimin nr. 893, datë 17.12.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullave të organizimit dhe të funksionimit të kabineteve ndihmëse, të organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore, si dhe për procedurat e hollësishme për përgatitjen, propozimin, konsultimin dhe miratimin e organizimit të brendshëm".....	15585
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 667, datë 10.11.2021	Për trajtimin e vullnetarëve për angazhimin e tyre në aktivitete të mbrojtjes civile apo në operacionet e parandalimit e të përballimit të fatkeqësive.....	15586
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 669, datë 10.11.2021	Për kriteret e emërimit, shkaqet e lirimit apo të shkarkimit, si dhe shpërblimi i anëtarëve të Komisionit Kombëtar për Azilin e Refugjatët.....	15587
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 671, datë 10.11.2021	Për rishpërndarje fondesh brenda programeve buxhetore të vitit 2021, miratuar për Ministrinë e Brendshme.....	15588
Kërkesë e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 116/12, datë 8.11.2021	Për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Zgjerimi i varrezave të qytetit Kavajë".....	15589

VENDIM
Nr. 664, datë 10.11.2021

PËR EMËRIM NË DETYRË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Ardi Veliu emërohet zëvendësministër i Infrastrukturës dhe Energjisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 665, datë 10.11.2021

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 586, DATË 30.8.2019, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PUNËSIMIN E PËRKOHSHËM TË STUDENTËVE TË EKSELENCËS NË INSTITUCIONET E ADMINISTRATËS SHTETËRORE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 2/1, të kreut III, të vendimit nr. 586, datë 30.8.2019, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të shtohet pika 2/2, me këtë përmbajtje:

"2/2. Përjashtimisht për vitin 2021:

a) pozicionet e dedikuara për studentët e ekselencës, për këtë vit, të plotësohen nga kandidatët e përzgjedhur nëpërmjet platformës "Gati për Shqipërinë", sipas së njëjtës metodologji të vlerësimit të kandidatëve të përcaktuar në pikat 1, shkronja "b", dhe 2, të kreut II, të këtij vendimi;

b) Departamenti i Administratës Publike të zhvillojë procedurën e radhës së punësimit të përkohshëm të studentëve të ekselencës, sipas përcaktimeve të kreut II, të këtij vendimi, nëse në përfundim të procedurës së zhvilluar sipas shkronjës "a", të kësaj pike, mbeten ende pozicione vakante të dedikuara për studentët e ekselencës.".

2. Ngarkohen Departamenti i Administratës Publike dhe institucionet e administratës shtetërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 666, datë 10.11.2021

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 893, DATË 17.12.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË ORGANIZIMIT DHE TË FUNKSIONIMIT TË KABINETEVE NDIHMËSE, TË ORGANIZIMIT TË BRENDSHËM TË INSTITUCIONEVE TË ADMINISTRATËS SHTETËRORE, SI DHE PËR PROCEDURAT E HOLLËSISHME PËR PËRGATITJEN, PROPOZIMIN, KONSULTIMIN DHE MIRATIMIN E ORGANIZIMIT TË BRENDSHËM"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17, pika 2; 21, pika 5, dhe 29, pika 1, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 29, të vendimit nr. 893, datë 17.12.2014, të Këshillit të Ministrave, të shtohen pikat: 29/1, 29/2, 29/3, 29/4 dhe 29/5, me këtë përmbajtje:

"29/1. Në institucione të sistemeve prioritare, sipas përcaktimit të Kryeministrit apo të Këshillit të Ministrave, në kuadër të miratimit të strukturës dhe organikës së tyre, krijohen qendrat e ekselencës, të dedikuara:

a) për të propozuar dhe/ose menaxhuar projekte apo iniciativa zhvillimore në fushat përkatëse;

b) për të kontribuar me njohuri dhe ekspertizë të posaçme, të nevojshme për një periudhë të

caktuar kohore, në fushën që mbulon institucioni e për të cilën mungojnë kapacitetet e nevojshme në institucion.

29/2. Numri i pozicioneve të punës në qendrat e ekselencës, të krijuara si pjesë e strukturave dhe organikave të institucioneve të administratës shtetërore, sipas pikës 29/1, të këtij vendimi, të jetë jo më shumë se 5 (pesë).

29/3. Marrëdhëniet e punës së nëpunësve në qendrat e ekselencës të rregullohen në bazë të dispozitave të Kodit të Punës.

29/4. Procesi i përzgjedhjes së kandidatëve për punësim në qendrat e ekselencës menaxhohet nëpërmjet platformës "Gati për Shqipërinë", nga komisionet e krijuara përkatësisht pranë Kryeministrisë apo ministrive, që kanë në sistemin e tyre këto njësi organizative. Ky proces realizohet nëpërmjet një procedure konkurruese, e cila zhvillohet në 2 (dy) faza:

a) Aplikimi i kandidatëve nga brenda apo jashtë Shqipërisë:

i. me ide për projekte apo iniciativa zhvillimore në fusha të caktuara, në rastin e përcaktuar në shkronjën "a", të pikës 29/1, të këtij vendimi;

ii. me ekspertizën e nevojshme në fushën për të cilën nevojitet ajo, në rastin e përcaktuar në shkronjën "b", të pikës 29/1, të këtij vendimi;

b) Vlerësimi i kandidatëve, nëpërmjet intervistave me gojë, ku anëtarët e komisioneve përkatëse gjykojnë për:

i. përputhshmërinë më të mirë të projekteve apo iniciativave zhvillimore të propozuara nga kandidatët me objektivat strategjikë të institucionit përkatës;

ii. ekspertizën më të mirë, në fushën ku është e nevojshme të ofrohet ajo.

29/5. Emërimi i kandidatëve, të përzgjedhur sipas pikës 29/4, të këtij vendimi, bëhet në njërin prej niveleve të ekspertëve në bazë të kritereve të mëposhtme:

a) Ekspert i kategorisë së parë – kandidati që ka të paktën 5 (pesë) vjet ekspertizë në fushën për të cilën ka konkurruar, të vërtetuar në kontratat përkatëse;

b) Ekspert i kategorisë së dytë – kandidati që ka deri në 5 (pesë) vjet ekspertizë në fushën për të cilën ka konkurruar, të vërtetuar në kontratat përkatëse.".

2. Ngarkohen Departamenti i Administratës Publike dhe institucionet e administratës shtetërore për zbatim e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 667, datë 10.11.2021

PËR TRAJTIMIN E VULLNETARËVE PËR ANGAZHIMIN E TYRE NË AKTIVITETE TË MBROJTJES CIVILE APO NË OPERACIONET E PARANDALIMIT E TË PËRBALLIMIT TË FATKEQËSIVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 38, të ligjit nr. 45/2019, "Për mbrojtjen civile", me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Trajtimin e vullnetarëve, për angazhimin e tyre në aktivitete të mbrojtjes civile apo në operacionet e parandalimit e të përballimit të fatkeqësive, për:

a) transportin:

i. në rast se vullnetari do të angazhohet në aktivitete të mbrojtjes civile apo në operacionet e parandalimit e të përballimit të fatkeqësive jashtë territorit të vendbanimit të tij të zakonshëm;

ii. kur transporti nuk realizohet nga vetë institucionet apo strukturat qendrore dhe vendore të mbrojtjes civile, pranë të cilave ofrohen vullnetarët, shpenzimet e transportit do të njihen kundrejt dokumentit tatimor përkatës, por jo më shumë se tarifa përkatëse, sipas distancës kilometrike të linjës, të miratuar në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për tarifat e transportit të udhëtarëve;

b) trajnimin, në rastet kur kryhet nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile;

c) ushqimin, sipas mënyrës së paracaktuar nga institucionet apo strukturat qendrore dhe vendore të mbrojtjes civile, pranë të cilave ofrohen vullnetarët, në varësi të situatës së krijuar, por jo më

shumë se vlera prej 2 500 (dy mijë e pesëqind) lekësh në ditë;

ç) mjetet e nevojshme për kryerjen e vullnetarizmit, të cilat do t'i jepen vullnetarit në përdorim nga institucionet apo strukturat qendrore dhe vendore të mbrojtjes civile, pranë të cilave ato ofrohen;

d) akomodimin, i cili, në varësi të aktiviteteve të mbrojtjes civile apo operacioneve të parandalimit e të përballimit të fatkeqësive, do të kryhet:

i. në formën e kompensimit, kundrejt dokumentit tatimor përkatës, të paraqitur nga hoteli dhe të shoqëruar me faturën e printuar nga kasa elektronike fiskale, por jo më shumë se 3 000 (tre mijë) lekë për çdo natë;

ii. në tenda/çadra apo struktura të tjera të përshtatura për akomodim.

2. Sigurimi i jetës dhe i shëndetit, për vullnetarët që angazhohen në aktivitete të mbrojtjes civile apo në operacionet e parandalimit e të përballimit të fatkeqësive, bëhet sipas kontratës së lidhur me shoqërinë e sigurimit, të përzgjedhur sipas rregullave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për prokurimin publik nga institucioni apo struktura qendrore dhe vendore e mbrojtjes civile, përgjegjëse për parandalimin e përballimin e fatkeqësisë, sipas natyrës së saj. Ky sigurim mbulon shpenzimet për trajtimin e dëmtimeve që vijnë si rezultat i angazhimit në aktivitete të mbrojtjes civile apo në operacionet e parandalimit e të përballimit të fatkeqësive, si më poshtë vijon:

a) vdekje si rezultat i dëmtimeve;

b) paaftësi e përhershme ose aftësi e kufizuar, ose një lloj i caktuar dëmtimi si rezultat i një aksidenti gjatë kohëzgjatjes së vullnetarizmit;

c) paaftësi e përkohshme, si rezultat i një aksidenti gjatë kohëzgjatjes së vullnetarizmit dhe për shkak të tij;

ç) paaftësi e përkohshme, si rezultat i një sëmundjeje të pësuar gjatë kohëzgjatjes së vullnetarizmit dhe për shkak të saj;

d) shërbime spitalore dhe/ose mjekësore në spitalet publike ose private brenda shtetit, kur mbulimet shëndetësore nuk ofrohen në spitalet publike të vendit.

3. Shuma e përcaktuar në kontratën e sigurimit për çdo punonjës të siguruar nuk mund të jetë më e ulët se 500 000 (pesëqind mijë) lekë.

4. Tarifa e primit të sigurimit përcaktohet në kontratën e sigurimit, por nuk mund të jetë më e ulët se 0.5 (zero pikë pesë) %.

5. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondi i miratuar i buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile.

6. Ngarkohen Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile dhe institucionet apo strukturat qendrore dhe vendore të mbrojtjes civile, pranë të cilave ofrohen vullnetarët, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 669, datë 10.11.2021

PËR KRITERET E EMËRIMIT, SHKAQET E LIRIMIT APO TË SHKARKIMIT, SI DHE SHPËRBLIMI I ANËTARËVE TË KOMISIONIT KOMBËTAR PËR AZILIN E REFUGJATËT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 78, të ligjit nr. 10/2021, "Për azilin në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kryetari i Komisionit Kombëtar për Azilin dhe Refugjatët është nëpunës civil i kategorisë së lartë drejtuese (anëtar i TND-së) dhe propozohet nga ministri përgjegjës për çështjet e azilit.

2. Katër anëtarët e tjerë të Komisionit Kombëtar për Azilin dhe Refugjatët (në vijim, Komisioni) propozohen nga secili prej institucioneve: Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Arsimit dhe Sportit, si dhe Shërbimi Informativ i Shtetit e duhet të plotësojnë këto kritere:

a) të jenë diplomuar në shkenca shoqërore;

b) të jenë nëpunës civilë ose në pozicione ekuivalente jashtë shërbimit civil, të paktën, të nivelit të mesëm drejtues;

c) të kenë eksperiencë profesionale jo më pak se 5 (pesë) vjet në administratën publike;

ç) të pajisen me certifikatë sigurie, niveli "sekret".

3. Anëtari i Komisionit lirohet nga detyra në rastet kur:

a) mbaron mandati;

b) jep dorëheqjen;

c) përfundon marrëdhënia e punës me institucionin që ai përfaqëson.

4. Anëtari i Komisionit shkarkohet nga detyra në rastet kur:

a) nuk merr pjesë pa arsye në mbledhjet e Komisionit për më shumë se 2 (dy) herë radhazi;

b) veprimet apo mosveprimet e tij kanë dëmtuar rëndë veprimtarinë e Komisionit;

c) nuk ruan konfidencialitetin e informacioneve ose i përdor ato për interesa personale;

ç) dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;

d) ushtron veprimtarinë në kushtet e konfliktit të interesit.

5. Anëtarët e Komisionit të shpërblehen sipas vendimit të Këshillit të Ministrave për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose të komisioneve të përhershme të njësive të qeverisjes qendrore.

6. Vendimi nr. 206, datë 16.3.2016, i Këshillit të Ministrave, "Për krijimin, përbërjen, organizimin dhe funksionimin e Komisionit Kombëtar për Azilin dhe Refugjatët", shfuqizohet.

7. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Shërbimi Informativ i Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 671, datë 10.11.2021

PËR RISHPËRNDARJE FONDESH BRENDA PROGRAMEVE BUXHETORE TË VITIT 2021, MIRATUAR PËR MINISTRINË E BRENDSHME

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të nenit 44, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.1998, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 137/2020, "Për buxhetin e vitit 2021", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në buxhetin e vitit 2021 bëhet rishpërndarja e fondeve brenda programeve buxhetore të miratuara për Ministrinë e Brendshme, si më poshtë vijon:

a) për programin "Garda e Republikës", në zërin "Shpenzime korrente", të shtohet fondi 31 000 000 (tridhjetë e një milionë) lekë, për plotësimin e nevojave për shpenzime personeli dhe shpenzime të tjera, për shkak të ndryshimeve të strukturave të Gardës në numrin e personelit, numrin e mjeteve dhe personaliteteve për t'u marrë në ruajtje, si organet e vlerësimit kalimtar, SPAK-u dhe BKH-ja;

b) fondi prej 31 000 000 (tridhjetë e një milionë) lekësh të përballohet nga pakësimi i buxhetit për programin "Gjendja Civile", në zërin "Shpenzime korrente", në shumën 21 00 000 (njëzet e një milionë) lekë, dhe në programin "Prefektura", në zërin "Shpenzime korrente", në shumën 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

KËRKESË
Nr. 116/12, datë 8.11.2021

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Zgjerimi i varrezave të Qytetit Kavajë".

Subjekti kërkues i këtij projekti është Bashkia Kavajë.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilët do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë", sipas tabelës paraprake bashkëlidhur.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 3,581,823.00 (tre milionë e pesëqind e tetëdhjetë e një mijë e tetëqind e njëzet e tre) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
KRYETAR I KOMISIONIT
TË POSAÇËM TË SHPRONËSIMEVE
Erlis Hereni

LISTA EMËRORE PARAPRAKE E PRONARËVE TË PASURIVE, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "ZGJERIMI I VARREZAVE TË QYTETIT KAVAJË"

Nr.	Emër Atësi Mbiemër	Nr. i pasurisë	ZK	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja e prekur	Vol.	Faqe	Çmimi /njësi lekë m²	Vlera në lekë	Kufizimet e pronësisë
1	Sulejman Rustem Allajbeu	12/32	8552	arë	2200	12	101	329	723,800.00	
2	Hajdar Rustem Allajbeu	12/33	8552	arë	2104	12	102	329	692,216.00	Kufizime në seksionin "D"
3	Jemin Rustem Allajbeu	12/34	8552	arë	2202	12	100	329	724,458.00	Kufizime në seksionin "D"
4	Besnik Rustem Allajbeu	12/35	8552	arë	2181	12	99	329	717,549.00	Kufizime në seksionin "D"
5	Hasan Rustem Allajbeu	12/36	8552	arë	2200	12	98	329	723,800.00	
Total									**3,581,823.00**	

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Viti: 2021 - Numri: 175
Datë: 2021/11/11 16:21:29
835a97c2-182d-4e77-805b-edc36273cddd

Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra e Botimeve Zyrtare)

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2021

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 32 lekë